



P Z A P  
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.33/2025

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Hajriz Hoti dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Aleksander Arsenijeviq, kryetar i Srpska Demokratja, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 16.01.2025, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.33/2025 e datës 14.01.2025 e parashtuar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Aleksander Arsenijeviq, kryetar i Srpska Demokratja, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

### ARSYETIM

Parashtruesi i ankesës subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, më datë 14.01.2025 kundër kryetarit të subjektit politik Srpska Demokratja, Aleksander Arsenijeviq me të cilën pretendon se i lartcekuri me datë 12.01.2025 rrëth orës 17:50 ka penguar vizitën e kryeministrit Albin Kurti në Veriun e Mitrovicës. Më tutje parashtruesi i ankesës theksón në kuadër të fushatës zgjedhore shtabi i Qendrës së LVV-së në Mitrovicë ka planifikuar aktivitetet për këtë ditë, ku një ndër to ishte edhe ndalja për kafe në lokalin “Misini” i cili gjendet në Mitrovicën e Veriut dhe pas takimit për kafe, kryeministri Albin Kurti është nisur për në tubimin që do të mbahej në ora 18:00 në Palestrën e Sporteve “Minatori”, aty doli Aleksander Arsinjeviq kryetar i Srpska Demokratja që tentoj ta pengoj aktivitetin i cili është paraparë në kuadër të fushatës, filloj të ofendoj, duke përdorur gjuhë ofenduese dhe me zë të lartë dhe duke i fishkëlluar kryeministrit Kurti dhe ministrave e deputetëve që ishin ne shoqërim të tij, duke nxitur urrejtje, fyerje të kandidatit për

kryeministër me ku me atë rast ka shkelur nenin 34 par.1 nën. Par.1.4 dhe 1.7 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, kjo fillojë të nxitë tensione dhe i njëjtë arrestohet nga Policia e Kosovës, pasi nuk përfilli rekomandimet dhe kërkesat që i njëjtë të ndalet, të mos ofendojë dhe të mos fishkellejë pasi që kjo pengonte aktivitetin.

Tutje parashtruesi i ankesës, thekson se kandidati nga radhët e Srpska Demokratija, Aleksandër Arsenijeviq, ka cënuar rëndë nenin 34 pika 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke penguar me veprimet e tij kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, njëherë kryeministrin e Republikës së Kosovës, z.Albin Kurti,. Parashtruesi i kërkonë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një link fotografi dhe video si provë ndaj shkeljes së pretenduar.

Më datë 15.01.2025, PZAP-i, e njoftoi kryetarin e subjektit politik Srpska Demokratja, Aleksander Arsenijeviq për ankesën e paraqitur kundër tij, duke i dërguar kërkesë përgjigje deri me 16.01.2025 në ora 12:00.

Në përgjigje në ankesë theksohet se sipas informacioneve të disponueshme publikisht, Vetëvendosje nuk ka shpallur fushatë aktivitet në Mitrovicë të Veriut për 12 janar të vitit 2025, e cila është komunë e veçantë nga komuna e Mitrovicës së Jugut, ku zyrtarisht kanë pasur aktivitet fushate atë ditë. Më tutje në përgjigje në ankesë theksohet se si mundeni të shihni në faqen zyrtare të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje nga 11 janari, ata kanë paralajmëruar aktivitet fushat në Mitrovicë e Jugut në këtë mënyrë :

<https://www.facebook.com/share/p/1CzRGqNk57/>

*“Nga cepi në cep në Mitrovicë ,  
Nesër , e diel , 12 janar , në sallën " Minatori " në Mitrovicë , me duke filluar nga ora 18:00 , takohemi në fushatën 500 mijë zemrat të cilat rrahin si një, në fushatën fitusese e cila arrin kulmin më 9 shkurt ”*

Sipas përgjigjes në ankesë, aktiviteti i fushatës ishte planifikuar në Mitrovicën e Jugut, jo në Mitrovicën e Veriut , ku ndodhi arrestimi Arsenijeviqit dhe më shumë se një orë para aktivitetit të paralajmëruar për orën 18:00, atë ditë, askush publikisht nuk ishte në dijeni se kryeministri Kurti po planifikonte një vizitë dhe në Mitrovicën e veriut. Sipas informacioneve tona nga Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ) Mitrovica e Veriut, Vetëvendosje nuk kishte paralajmëruar asnjë takim në Mitrovicën e Veriut për 12 janar të vitit 2025, që është obligim i subjekteve politike sipas nenit 4 pika 3 dhe 4 të “ Rregullës Zgjedhore nr. 07/2024 për fushatën zgjedhore, monitorim i fushatës zgjedhore dhe raportimi financiarë”.

Tutje në përgjigje në ankesë shpjegojnë çfarë ndodhi nga perspektiva e tyre: Presidenti i Demokracisë Serbe, Aleksandar Arsenijeviq, rrëth orës 16:30 ( pothuajse dy orë përpëra aktivitetit të paralajmëruar të Vetëvendosjes në Mitrovicën e jugut ) shkoi në zonën këmbësorë në Mitrovicën e veriut, kur e ndaloi kordon policia, dhe i pamundësi për të lëvizur më tej. Si çfarë ju mundeni shih në videon live e

bashkëngjitur, Aleksandar Arsenijević nga ajo ditë (në të cilën ju mundeni shih datën dhe orën, 12 janar, ora 16:56), Arsenijeviq gjithë kohen ka pyetur zyrtarët të policisë pse iu është pamundësuar lëvizja, në çka askush nga policët nuk është iu përgjigjur, as nuk informoi se ndonjë parti kishte shpallur aktivitet të fushatës aty pranë. Ai për shkak të parandalimit të lirisë së lëvizjes protestoi dhe fishkëlloj, në çfarë më vonë ju bashkuan dhe anëtarë të tjerë të Partisë Demokracia Serbe. Arsenijeviq në fund është arrestuar dhe askush nuk i ka shpjeguar më parë pse nuk mundet më tej të lëvizë. Sipas përgjigjes në ankesë aktivistë e partisë demokracia serbe vetëm më vonë nga mediat kuptuan se ata aktorët nga Vetëvendosje kishin një vizitë në Mitrovicë të veriut më shumë se 50 metra më tej nga kordoni, sepse askush nga ajo distanca nuk mund të shihte se kush po lëvizte 50 metra më larg se kordoni, dhe nëse mbahet fushat parazgjedhore. Sigurisht, duke pasur parasysh se kjo ngjarje nuk ishte i paralajmëruar nga KKZ i Mitrovicës së Veriut, dhe se as nuk është shpallur për publikun, ai nuk mundet trajtoj si fushat parazgjedhore, prandaj ne konsiderojmë se ankesa është e pabazuar.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Me nenin 34 par.1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.7 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës është përcaktuar se: “*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohet çrregullimi i tubimeve të subjekteve tjera politike ose nxitja e të tjerëve për një veprim të tillë.*” Ndërsa në nën paragrafin 1.7 theksohet se “*gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohet kërcënimi ose tentimi për të kërcënuar subjektet e tjera politike, përkrahësit e tyre*”.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e kandidatit nga radhët e subjektit politik Srpska Demokratija, Aleksandër Arsenijeviq, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, përfaktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur vetëm një video incizim, ku shfaqej Arsenijeviq duke fishkëlluar e që për Panelin nga këto pamje të shfaqura në këtë video nuk mund të merret se i njëjtë ka shkelur nenin 34 par.1 nën. Par.1.4 dhe 1.7 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme gjegjësisht se ka bërë çrregullimin apo pengimin e ndonjë tubimi të ndonjë subjekti politik, pasi që në ato pamje të shfaqura nuk vërehet se është duke u mbajtur ndonjë tubim zgjedhor i subjektit politik në fjalë.

Paneli nuk mund ta merr si te mirëqenë dhe të vërtet pretendimin për të cilin pala ankuese ju është referuar, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtruar e konsideron të pa bazuar në fakte, dëshmi të qarta dhe bindëse konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe mbi këtë arsyen vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 33/2025 më datën 16.01.2025

**Kryesuese e Panelit**

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.